



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
DREJTORIA E AUDITIMIT

Nr. 1985<sub>5</sub> prot.

Tiranë, më 21.07.2021

Lënda : Dërgim i Raportit Final të Auditimit

Drejtuar: **Z. BAKI BALA**  
**PREFEKTIT TË QARKUT**

**FIER**

I nderuar z. BALA,

Bashkëlidhur dërgojmë Raportin Final të Auditimit, mbi auditimin e kombinuar të kryer në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier, nga grupi i auditimit të Drejtorisë së Auditimit në Ministrinë e Brendshme: znj. Maria Markaj, znj. Natasha Uruçi dhe Blerina Dervishaj..

Auditimi përfshiu periudhën nga 01.07.2019 deri më 31.03.2021 dhe u krye në zbatim të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Urdhrit të MF nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar, planit të auditimit për vitin 2021, miratuar nga Ministri i Brendshëm nr. 335, datë 19.10.2019, "Për miratimin e Planit Vjetor të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2020", Autorizimit për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim nr.prot.1985, datë 16.04.2021, Njoftimit të auditimit nr.prot.1985/1, datë 16.04.2021 dhe Programit të punës nr. prot. 1985/2, datë 14.05.2021.

Në zbatim të pikës d, të nenit 12 "Përgjegjësitë e titullarëve" të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditin e brendshëm në sektorin publik" dhe pikave: 4.1.12 "Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar"; 4.1.13.1, "Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit", të Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, ndryshuar me urdhrin e MFE nr.4 datë 10.01.2020, nga ana Juaj të hartohet dhe të miratohet Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit dhe të dërgohet zyrtarisht pranë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në MB, **jo më vonë se 30 ditë kalendarike** nga marrja e Raportit Final të Auditimit.

Në zbatim të pikës 4.1.13.3, "Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB" të MAB, së bashku me Planin e Veprimit duhet të dërgoni ndryshime nëse ka lidhur me caktimin e një punonjësi me përvojë që të evidentojë rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë dhe informojë vazhdimisht në MB për progresin që është bërë për zbatimin e tyre. Në përfundim, Grupi i auditimit do njohë Ministrin me procesin e auditimit dhe me Planin e veprimit të sjellë nga Institucioni i Prefektit Fier. Lutemi të na dërgoni edhe Feedback-un e plotësuar nga ana Juaj, formatin e të cilit po e dërgojmë bashkëlidhur kësaj shkrese.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin,

DREJTOR I AUDITIMIT  
Arjan SULAJ



Përgjithësisht spjegimet janë dhënë për situatat mbi të cilat janë evidentuar gjetjet për të cilat janë dhënë rekomandime sipas gjykimit profesional të auditit. Sqarohet se sipas akteve që normojnë veprimtarinë audituese (ligji i auditimit, manuali i auditimit dhe Standardet ndërkombëtare dhe praktikat profesionale të auditimit të brendshëm në sektorin publik, të pranuar për tu zbatuar në Republikën e Shqipërisë, janë miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.40 datë 8.5.2017), mosdakortësia me rekomandimin (apo dakortësia e pjesëshme), përcakton që drejtuesit e nivelit të lartë të menaxhimit të subjektit të audituar, kanë pranuar riskun që vjen nga mos marrja e veprimeve korrigjuese.

### **III. METODA E AUDITIMIT**

Mbi bazën e të dhënave të dosjes së përhershme të auditimit për këtë organizatë, është plotësuar formulari standard nr.4 "*Vlerësimi i Riskut për Mjedisin e Përgjithshëm të Kontrollit*", sipas të dhënave të këtij formulari, risku rezultoi "i mesëm", është përgatitur Projekt Programi i Auditimit dhe filloi puna në terren pas konfirmimit elektronik nga organizata për kryerjen e këtij angazhimi. Sipas pikave të P/Programit dhe fushave të identifikuara të llogarisë, u krye vlerësimi i riskut për këto fusha/sisteme. Pas kombinimit me vlerësimin e riskut për mjedisin e kontrollit, rezultoi vlerësimi i riskut të përgjithshëm "i mesëm".

U përgatit Programi i Punës për auditim të kombinuar, përputhshmërie e financiar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier dhe u miratua me shkresën prot nr. 1985/2, datë 14.05.2021. Nga audituesit u kryen teste të ndryshme duke vlerësuar efektivitetin e tyre në sistemin e kontrollit.

Gjatë zhvillimit të angazhimit të auditimit, u përdor metodologjia e auditimit hap pas hapi dhe u arrit në një opinion mbi funksionimin e sistemit të kontrollit dhe kontrollet e munguara. Për realizimin e këtij auditimi u përdor teknika e sondazheve me përzgjedhje sipas gjykimit profesional duke ekzaminuar proceset përfaqësuese të veprimtarisë së këtij institucioni për periudhën nën auditim. Auditimi u krye në zbatim të standarteve të miratuara për auditimin e brendshëm në sektorin publik.

### **IV. GJETJE DHE KONKLUZIONE**

**Subjekti i Audituar:** Institucioni Prefektit të Qarkut Fier.

**Njësitë/ subjektet e interesuara nga gjetjet:** Ministria e Brendshme; Institucioni Prefektit të Qarkut Fier; Agjencia e Mbrojtjes së Burimeve Ujore; Zyra Administrimit të Basenit Ujor Seman; ASHK; Avokatura e Shtetit, etj.

**Përmbledhja e bazës ligjore:** Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"; ligji nr.107/2016, datë 14.11.2016 "Për Prefektin e Qarkut"; ligji nr.139/2015 "Për Qeverisjen Vendore"; ligji nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar; ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; ligji nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", ndryshuar me ligjin nr.6/2018, datë 8.02.2018; VKM nr.696 datë 30.10.2019, "Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre"; Rregullorja e brendshme e Këshillit të Basenit Ujor (Seman), e miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit me vendimin nr.6 datë 12.06.2019, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujor"; Etj.

#### **IV.1 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve**

*Marrja në konsideratë e rekomandimeve të lëna nga auditët e mëparshëm. Hartimi i planit të veprimit me persona përgjegjës dhe afate konkrete për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm. Auditimi mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna, përgjegjësitë dhe arsyet e moszbatimit të tyre.*

Metoda e auditimit për sistemin e zbatimit të detyrave e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, u krye hap pas hapi, për të vlerësuar nëse funksionon sistemi i kontrollit në zbatimin e rekomandimeve. Në përfundim të auditimit, rezultoi si më poshtë:

Institucioni Prefektit të Qarkut Fier është subjekt auditimi nga Drejtoria e Auditimit në Ministrinë e Brendshme, e cila ka ushtruar auditim deri më datën 31.06.2019. Përfundimet e këtij auditimi, së bashku me Raportin Final të Auditimit, janë dërguar me shkresën e Drejtorisë së Auditimit nr. prot.5452/5 datë 21.10.2019.

Nga auditimi rezultoi se janë marrë në shqyrtim konkluzionet e auditimit të mëparshëm, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi, është përgatitur Plani i veprimit i cili është i miratuar nga Prefekti dhe është dërguar brenda afatit në Drejtorinë e Auditimit me shkresë e Prefektit nr.1771, datë 14.11.2019, hyrë në ministri me shkresën nr. prot.5452/6 datë 20.11.2019. Nga Institucioni Prefektit është raportuar progresivisht mbi realizimin e rekomandimeve në rrugë elektronike (dhe me shkresën nr.1109 datë 30.10.2020, hyrë në ministri me shkresën nr.2803 datë 16.11.2020). Me shkresën e dërgimit të Planit të veprimit është dërguar dhe personi përgjegjës për ndjekjen e raportimin e zbatimit të rekomandimeve z. Arben Velo (Sekretari Përgjithshëm).

Në auditimin e fundit janë lënë për zbatim pesë rekomandime si dhe është kërkuar nëpërmjet rekomandimit të parë zbatimi i 29 rekomandimeve të mbetura në proces nga auditimet e mëparshme. Nga auditimi i statusit të zbatimit të 29 rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm (22 rekomandime janë për KVVTP-në) rezulton se janë realizuar vetëm dy rekomandime të lëna në auditimin e fundit dhe mbeten në proces realizimi pesë rekomandime pasi, për shkak të risrukturimit të strukturës së KVVTP-së nuk janë zbatuar gjithësej 22 rekomandimet e lëna për këtë strukturë (nga të cilat 19 rekomandime të auditimeve të mëparshme dhe tre rekomandime të lëna në auditimin e fundit). Konkretisht realizimi i rekomandimeve është si më poshtë:

1. Rekomandimi: Rekomandimet e pazbatuara dhe ato në proces zbatimi nga auditimet e mëparshme (trajtuar në pikën e parë të programit) të përfshihen në planin e veprimit të radhës duke përcaktuar afate dhe persona përgjegjës konkret për zbatimin e tyre si dhe linjat e raportimit tek eprori për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e sistemeve në vijim. Menaxhimi i lartë i organizatës të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme progresin e bërë për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme dhe të raportojë periodikisht në Drejtorinë e Auditimit në MB. Ky rekomandim është zbatuar, janë përfshirë rekomandimet e pazbatuara në Planin e veprimit dërguar me shkresën e Prefektit nr.1771 datë 14.11.2019, hyrë në ministri me shkresën nr. prot.5452/6 datë 20.11.2019.

2. Rekomandim: Menaxhimi i lartë i organizatës të marrë masa për gjetjen e adresave të personave fizikë e juridikë debitorë, të kërkojë zyrtarisht nga DPP Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, adresat e vendbanimit dhe të punësimit të tyre, të kërkojë në gjykatën administrative të shkallës së parë Fier arkëtimi i 23 debitorëve të krijuar në vite (para vitit 2014).

Ky rekomandim *nuk është realizuar*. Nuk ka ndonjë komunikim shkresor për periudhën e audituar.

3. Rekomandim: Menaxhimi i lartë i Institucionit në bashkëpunim me DAP të kryejnë procedurat e duhura administrative për plotësimin në organikë të 8 pozicione vakante.

Ky rekomandim është në proces zbatimi. Organika e këtij institucioni në fund të muajit Mars 2021 nuk ishte plotësuar me tre punonjës: në Sektorin e planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave një punonjës (përgjegjësi sektorit), në sektorin e Zhvillimit Urban (specialisti) dhe sekretari i titullarit.

4.Rekomandim: Sektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse të marrë në evidencë kontabël vlerën prej 60,000 lekë në ngarkim të punonjësit Endri Spahiu dhe të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimit.

Ky rekomandim *nuk është realizuar*. Nuk ka ndonjë komunikim shkresor për periudhën e audituar.

5. Rekomandim: Strukturat menaxhuese të Institucionit të Prefektit Fier në hartimin e regjistrit të rrishtit të identifikojnë rrishtin (i brendshëm ose i jashtëm) mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme duke marrë masa për minimizimin e tij, zbatimi i rekomandimeve

ndikon në arritjen dhe realizimin e objektivave të Institucionit. Grupi i Menaxhimit Strategjik të diskutojë dhe të marrë në analizë të metat e mangësitë në hartimin e regjistrit të riskut si dhe të hartohet plan veprimi i menaxhimit të riskut. Ky rekomandim është zbatuar.

6. Rekomandim: Menaxhimi i lartë i organizatës të hartojë gjurmën e auditit për nxjerrjen e përgjegjësisë para likuidimit të vendimeve gjyqësore, në zbatim të pikës 62 të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “ Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.

Ky rekomandim është në proces zbatimi. Për periudhën e audituar, nuk ka likuidime të vendimeve gjyqësore.

7. Rekomandimi: Prefekti i Qarkut Fier, të ngrrejë një komision me specialist të fushës për verifikimin në terren në të gjithë territorin e Qarkut Fier të venkomandave dhe vendstrehimeve të kohës së veçantë dhe të ndjekë hapat ligjorë për kalimin e tyre nën administrim të Institucionit të Prefektit dhe bashkive, siç përcaktohet në pikën 8 të VKM Nr. 655, datë 18.12.2002. Ky rekomandim nuk është zbatuar. Nuk është bërë verifikimi në terren për vendkomandat dhe vendstrehimet dhe nuk kanë kaluar ato në pronësi të Institucionit të Prefektit apo bashkive.

Rekomandimet e lëna për drejtorinë e KVVTP- së (22 rekomandime, pa zbatuar, për shkak transferimi të kësaj strukture).

1.Rekomandim i DA: KVVTP në Institucionin e Prefektit Fier të rihetojë procedurat administrative në lidhje me vendimin nr.25, datë 29.06.2010 i marrë sipas vlerësimit ligjor të KVVTP të datës 25.06.2010 “Për shqyrtimin e kërkesës për vlefshmërinë ligjore dhe korigjimin e titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe të vlerësojë sipërfaqen e tokës prej 2550 m<sup>2</sup> tokë bujqësore të shtuar më shumë se sa ka AMTP. Rekomandimi ka të bëjë me korigjimin nga KVVTP të AMTP pasi është shtuar në pronësi të shtetasit Arqile Gjeka një sipërfaqe prej 2550 m<sup>2</sup> tokë bujqësore. *Puna e bërë për zbatimin e rekomandimit deri në reformimin e strukturës:*KVVTP e Prefektit Fier, ka rifilluar hetimin administrativ. Është bërë njoftimi i bashkëpronarëve të familjes bujqësore, (njoftimi i fundit më datë 21.05.2019 nga shërbimi Postar Divjakë). Njoftimi është kthyer me shënim (Është larguar pa adresë).

2.Rekomandimi DA: KVVTP, të fillojë menjëherë procedurën e shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të secilit AMTP, për rastet e evidentuara me sipërfaqe toke bujqësore të dhënë tepër familjeve të cilat rezultojnë të jenë banorë më 01.10.1992 dhe sipërfaqe të përfituara nga familjet të cilat nuk kanë qënë banorë me 01.10.1992, pra nuk kanë qënë subjekte të ligjit.

3.Rekomandimi i KLSH: Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, pasi të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë dhe pasi të identifikojë gjendjen juridike dhe treguesit identifikues të pasurive objekt në 24 raste vendime me mbi 32 pasuri me sipërfaqen 135761 m<sup>2</sup> të llojit Tokë Bujqësore, të periudhës 2013-6/muj. I 2014 dhe 15 raste vendime me 19 pasuri, me sipërfaqen prej 139893 m<sup>2</sup> të llojit tokë bujqësore, troje etj. të viteve 2009-2012, si dhe pasi të rishqyrtojë vendimet e KVVTP, t,i dërgojë në ZVRPP Fier, në zbatim të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e Vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" i ndryshuar, dhe të ligjit nr.33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", si dhe të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP" miratuar me vendimin nr.1, datë 27.03.2009 të KQT.

*Puna e bërë për zbatimin e rekomandimit deri në reformimin e strukturës:*Për vendimet e marra nga KVVTP për pavlefshmëri të plotë ose të pjesëshme të titujve të pronësisë, janë njoftuar zyrtarisht ZVRPP Fier, Lushnje e Mallakastër. Nga vendimet gjyqësore që kanë marrë formën e prerë të gjykimit dhe janë ekzekutuar, i është kthyer shtetit 4.94 ha tokë bujqësore. Ndërsa pjesa tjetër e vendimeve të marra nga KVVTP, për një sipërfaqe toke prej 11,73 ha tokë bujqësore, vazhdon procesi gjyqësor në dy shkallët e gjyqësorit. Ekzekutim i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, bëhet nëpërmjet procesverbalit të dorëzimit të tokës bujqësore, i cili nënshkruhet nga drejtori i KVVTP dhe drejtori i DAMT pranë KQ Fier.

4.Rekomandimi i KLSH: Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë si dhe të rinisë procedurat pasi të identifikojë pasuritë dhe të plotësojë kërkesë paditë me dokumentacionin përkatës lidhur me Vendimet KVVTP nr.13/1, datë 28.01.2010, nr.13/2, datë

28.01.2010 dhe nr.13/3, datë 28.01.2010, për sipërfaqen prej 7300 m<sup>2</sup> që ka shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën 3,359,200 lekë nga mbajtja dhe përlitimi i padrejtë i pasurisë me tituj pronësie të pavlefshëm (pasurisë "shtet"), në zbatim të ligjit nr.9948 datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar, dhe rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP" të miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.03.2009 të KQT.

*Puna e bërë për zbatimin e rekomandimit deri në reformimin e strukturës:* Për Vendimet e mësipërme, janë bërë padi në gjykatë, ka kaluar të gjitha shkallët e gjykimit dhe nga Gjykata e Lartë janë kthyer për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Pas përfundimeve të gjykimit nga gjykata e shkallës së parë, janë bërë sërish ankimime nga shtetasit Kristaq, Skender dhe Leonora Toska. Nuk ka përfunduar gjykimi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, pra është në proces gjyqësor.

5.Rekomandimi i KLSH: Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë si dhe të rinisë procedurat gjyqësore, pasi të identifikojë pasuritë dhe të përfshijë si palë ZVRPP Fier, si dhe plotësoje kërkesë paditë me dokumentacionin përkatës lidhur me Vendimet KVVTP nr.7/1, nr.7/2, nr.7/3, nr.7/4, dhe nr.7/5, date 26.11.2009, ripërsëritur me vendimet nr.77/1, nr.77/2, nr. 77/3, nr.77/4, dhe nr.77/5, datë 02.06.2011, për sipërfaqen prej 45,700 m<sup>2</sup> që ka shkaktuar dëmin ekonomik në vlerën 11,927,700 lekë nga mbajtja dhe përlitimi i padrejtë i pasurisë me tituj pronësie të pavlefshëm (pasurisë "shtet"), në zbatim të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar, dhe rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP" të miratuar me vendimin nr.1, datë 27.03.2009 të KQT.

*Puna e bërë për zbatimin e rekomandimit deri në reformimin e strukturës:* Për vendimet nr.77/2 e 77/4, datë 02.06.2011, është pezulluar gjykimi pasi në gjendjen familjare ka të vdekur dhe mungojne "Dëshmitë e Trashëgimisë. Prefekti i Qarkut me shkresë nr.294/1, datë 02.03.2018, ka kerkuar MBZHR, shumën prej 480,000 lekë shpenzime për Dëshmi Trashëgimie, por për llogari të KVVTP nuk akorduar asnjë fond. Vendimi nr.77/3, datë 02.06.2011 është në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Vendim nr.77/5, datë 02.06.2011, është ekzekutuar nga Zyra Përmbaremore Fier shuma prej 2,088,000 lekë. Për vendimin nr.77/1, datë 02.06.2011, për shumën 3,862,800 lekë, është dërguar për ekzekutim Zyrës Përmbaremore Tiranë me shkresë nr.169/92, datë 07.09.2015. Me shkresë nr.169/31, datë 05.06.2018 nga Institucioni i është kërkuar Zyrës Përmbaremore informacion mbi ekzekutimin e vendimit por nuk është kthyer asnjë informacion.

6.Rekomandim DA: Të gjitha kërkesat dhe dokumentet e tjera të ardhura për trajtim për KVVTP-në përfshirë dhe dokumentet që u përkasin kërkesave të mëparshme, të regjistronen në protokollin e Institucionit dhe të shoqërohen me kartelë shoqëruse duke adresuar personat përgjegjës për ndjekje e zbatimin e tyre. Paralelisht të vazhdohet të mbahet regjistri i kërkesave nga vetë struktura e KVVTP-së i cili të protokollohet, të numërohet dhe të vuloset nga protokollin. Të rakordohet periodikisht regjistri i vendimeve i mbajtur nga KVVTP-ja me kërkesat e protokolluara dhe të evidentohet punonjësi i ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e kërkesës.

*Puna e bërë për zbatimin e rekomandimit deri në reformimin e strukturës:* Kërkesat nga shtetas ose institucione shtetërore, drejtuar KV, më parë nuk janë regjistruar në protokollin e Institucionit por vetëm në protokollin e KVVTP. Nga fillimi i vitit 2018 e në vazhdim, protokollimi i kërkesave është bërë në protokollin e Institucionit, por nga KVVTP e Prefektit, nuk është hapur dhe nuk mbahet regjistri i kërkesave të shtetasve ose Institucioneve shtetërore.

7. Rekomandim DA: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të marrë të dërgojë me shkresë gjetjen e mësipërme pranë Sekretariatit Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës praktikën e ndjekur me Institutin e Sigurimeve Shoqërore duke kërkuar vërtetimet nga sigurimet shoqërore, të cilat vërtetojnë se asnjëri prej anëtarëve të mbajtësve të AMTP-së nuk figuron në mardhenien pune të përhershme me sektorin shtetëror apo privat (mbeshtetur në kërkesat e vendimit nr.255, datë 2.8.1991) dhe pamundësinë e sigurimit të të dhënave sipas kërkesave të Udhëzimit nr.2, datë 13.01.2010 dhe të kërkojë zgjidhje për praktikën në vijim.

*Puna e bërë për zbatimin e rekomandimit deri në reformimin e strukturës:* Janë dërguar kopjet e vendimeve të KVVTP si dhe informacionet e marra nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore Fier, me shkresën e Institucionit nr.1844, datë 08.11.2018 pranë Sekretariatit Teknik të KQT, por nuk ka ardhur informacion nga ky sekretariat.

8. Rekomandim DA: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të bëjë inventarizimin e dosjeve duke përcaktuar dorëzuesin dhe marrësin në dorëzim dhe të kryejë arkivimin e dosjeve në përputhje me gërmën dh) nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, VKM nr.1269, datë 17.9.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” pika III “Përbërja, mënyra e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë” dhe nenin 4 i Rregullores së Brendshme të KVTP-së.

9.Rekomandim DA: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit Fier, të marrë në analizë gjetjet për vendimet e KV-së nr.97, datë 23.10.2017, nr.101 dhe 102, datë 6.4.2018 lidhur me mospërputhjen midis të dhënave të AMTP-së dhe planvendosjes përkatëse e ngastrave për të cilat në vendim është kërkuar shfuqizimi i pjesëshëm i AMTP-së. Të saktësohet sipërfaqja e cila do kalojë nga mbajtësi i AMTP-së në shtet me planvendosjet e përgatitura nga specialisti i fushës.

10.Rekomandim DA: Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë të kërkojë menjëherë nga ZVRPP Fier njehësimin me origjinalin të dokumentit bazë mbi bazën e të cilit kryhet verifikimi i vlefshmërisë së AMTP-së i sjellë nga z.Nikollaq Deliu, konkretisht: Fotokopje të AMTP-së për z.Sabri Karamani, me vulë të Kryetarit të Ish rrethit. Referuar përgjigjes së marrë nga ZVRPP, të kryhet hetimi administrativ deri në marrjen e vendimit përfundimtar për kërkesën e z. N.Deliu. Në momentin e fillimit të hetimit administrativ, të bëhet me dije DAB në MB e cila nëse kërkohet do të vënë në dispozicion me procesverbal dorëzimi kopje të dokumenteve e sjella nga ankimuesi lidhur me këtë AMTP.

*Puna e bërë për zbatimin e rekomandimit deri në reformimin e strukturës:*Për këtë kërkesë, KVVTP ka marre dy vendime. Shtetasi nuk ka qënë dakord me vendimet dhe i është Gjykatës Administrative të Shkallës se Parë Vlorë. Me vendim nr.445, datë 09.04.2019 Gjykata Administrative të Shkallës se Parë Vlorë, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në fakte, prova e në ligj. Paditesi Nikollaq Deliu, ka bërë ankimim kundra vendimit dhe çëhtja është në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

11. Rekomandimi i KLSH: Institucioni i Prefektit të Qarkut dhe KVVTP, të marrin masat për plotësimin e përbërjes, përmirësimin e funksionimit, vënien në efijence, vendosjen e IT, administrimin e kërkesave dokumentacionit evidencave çeljen dhe mbajtjen e regjistrit te kërkesave, regjistrit te vendimeve dhe regjistrit te ankesave, deri tani të munguara dhe të marrë nen administrim informacionin dhe data bazën, sipas legjislacionit”.

12. Rekomandimi i KLSH: “Sekretariati Qendror Teknik pranë Komisionit Qeveritar të Ndarjes së Tokës pas njohjes me Raportin Përfundimtar të Auditimit të analizojë gjendjen, nxjerrë Përgjegjësitë për gjendjen e verifikimit të Titujve të pronësisë në KVVTP Fier, dhe të marrë masat e plotësojë detyrimet lidhur me: “Miratimin e formatit-tip të Regjistrit të Kërkesave, si dokument bazë i evidentimit, ndjekjes së ecurisë së kërkesave sipas stadeve, në funksion të respektimit të procedurave të afateve ligjore dhe të rritjes së transparencës ndaj publikut, në zbatim të KPA, ligjit nr.9948 dhe të rregullores”.

13. Rekomandimi i KLSH: “Sekretariati Qëndror Teknik pranë Komisionit Qeveritar të Tokës pas njohjes me Raportin Përfundimtar të Auditimit të analizojë gjendjen dhe të marrë masat për përdorimin e formave të trajnimit të stafeve apo dhe forma të tjera të shkëmbimit të eksperiencës me qarkore të ndryshme, apo kontaktet me KVVTP me eksperiencë”.

14.Rekomandim DA: Prefekti i Qarkut, të shohë mundësinë e rekrutimit në përbërje të stafit të KVVTP-së të një inxhinieri gjeodetë ose teknikë topografë të licensuar, për të mundësuar hartimin më profesional të planvendosjes së ngastrës/ave dhe rakordimit me hartat që administrohen në ZVRPP dhe DAMT, dhe në terren.



15. Rekomandim DA: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Fier, të marrë masa, që shqyrtimin e kërkesave të ardhura nga subjektet private dhe institucionet shtetërore ti bëjë brenda afatit ligjor.

16. Rekomandim DAB: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të zbatoj programin vjetor për kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet, dhe të miratuar nga Komisioni Qeveritar i Tokës Tiranë.

*Puna e bërë për zbatimin e rekomandimit deri në reformimin e strukturës:* Janë miratuar urdhrat nr.12, 13, 14 datë 06.04.2018 për kontrolle të drejtpërdrejta në ish-NB Portëz, Sheq-Marinëz, me afati perfundimi datë 30.11.2018, kontrollet nuk janë realizuar për mosdhënie informacionit nga Institucionet shtetërore.

17. Rekomandim DA: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të marrë masa, të bëjë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtarëve të komisionit të ndarjes së tokës në fshat, të cilët pasi kanë tejkaluar kompetencat ligjore, kanë sjelle, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit, duke ndarë tokë bujqësore mbi normën për frymë.

18. Rekomandim DA: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të kërkojë konfirmim nga Kryetari i bashkisë përkatëse i dokumenteve të njëjësive administrative të varësisë të cilat janë përdorur gjatë shqyrtimit administrativ të AMTP-ve dhe marrjen në 11 raste të vendimeve përkatëse, të trajtuara në mënyrë analitike në raportin auditimi.

19. Rekomandim DA: Prefekti i Qarkut dhe Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të marrë në analizë problemet e konstatuara nga auditi lidhur me trajtimin e kërkesës (bërë me shkresën nr.189 datë 31.07.2013) së shtetasit Ilir Naska për shfuqizimin e 37 AMTP-ve të lëshuara për pasurisë nr.84 në fshatin Mujalli Drizë, Njësia Administrative Qendër Fier, Bashkia Fier, për tokë "Pyll" i ndarë nga komisioni i ndarjes së tokës në kundërshtim me ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për tokën". KVVTP-ja të kërkojë shkresërisht ZVRPP Fier që të vënë në dispozicion AMTP-të e njehsuara me origjinalin për 37 AMTP-të e lëshuara për të cilat pretendohet se përfshihet edhe pasuria nr.84 në fshatin Mujalli Drizë, dhe të fillojë shqyrtimin administrativ të vlefshmërisë së tyre për të gjitha pasuritë që përshkruhen në këto AMTP.

20. Rekomandim DA: Për tre vendime të marra nga KVTP-ja: nr.86, 90 dhe 91 datë 12.09.2017 për shfuqizimin e pjesëshëm të tre AMTP-ve me sipërfaqe 5272 m<sup>2</sup>, për të cilat statusi i gjendjes gjyqësore është "Pezullim", të merren masa për përfundimin e këtyre çështjeve në favorin e shtetit (nepërmjet përgatites konkluzioneve dhe korigjimit të kërkesë padive, sigurimit të dëshmive të njoftimit të mbatësit të AMTP-ve, nxjerrjes së dëshmive të trashgimive). Të llogaritet dhe të kërkohet shkresërisht fondi që nevojitet për nxjerrjen e dëshmive të trashëgimisë për personat e vdekur që janë në proces gjyqësor duke argumentuar dhe riskun e mosparaqitjes së tyre në proceset gjyqësore.

21. Rekomandim DA: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit Fier, të përfundojë shqyrtimin administrativ sipas kërkesës së bërë nga shtetasja B.Çela e të dalë me vendim për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP-së për z. Riza Hekuran Çela.

22. Rekomandim DA: KVVTP pranë Prefektit, nën mbikqyrjen e Prefektit, të planifikojë e të kryejë kontrolle në zonat me përparësi turizimin. Për vonesat nga që krijohen nga Institucionet e tjera, KVVTP të njoftojë Prefektin, i cili duhet të marrë masat përkatëse ndaj këtyre Institucioneve. KVVTP të shqyrtojë të gjitha kërkesat e individëve apo enteve shtetërore, në drejtim të zbatimit të afateve. Për kërkesat, të cilave ju ka kaluar afati i shqyrtimit, të merren masa të menjëhershme për kryerjen e hetimit administrativ.

Këto 22 rekomandime të lëna për drejtorinë e KVVTP së nuk janë zbatuar pasi nuk ka strukturë përkatëse në institucion për zbatimin e këtyre rekomandime për shkak të reformimit të saj, në zbatim të ligjit nr.10/2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9948 datë 07.07.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i ndryshuar", neni 18, drejtorisë së KVVTP pranë Prefektit të Qarkut, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës.

**Titulli gjetjes:** Moszbatimi rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparëshme.

**Nr. Gjetjes 1**